



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 216, datë 29.12.2020

**PËR
MARRJEN E MASAVE
NDAJ SHOQËRISË “EUROTRADE SECURITIES” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2 dhe pika 21, si dhe nenit 31, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në mbështetje të nenit 19, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, ushtroi inspektim në vend pranë shoqërisë “Eurotrade Securities” sh.a., me objekt kryesor veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit në tituj për periudhën shtator 2018 – shtator 2020.

Inspektimi u krye nga data 14 tetor 2020, deri më datë 16 tetor 2020. Gjetjet e inspektimit i janë vënë në dispozicion shoqërisë, e cila ka depozituar në AMF observacionet përkatëse lidhur me këto gjetje me shkresën nr. 32 prot., datë 19.11.2020.

Përveç çështjeve për të cilat janë dhënë rekomandime, konstatohet se shoqëria nuk ka respektuar afatin e përcaktuar nga grupi i inspektimit për vënien në dispozicion të regjistrimeve të telefonatave dhe nuk ka plotësuar kërkesën mbi numrin e regjistrimeve/telefonatave të kërkuara, duke penguar Autoritetin të ushtrojë mbikëqyrjen sipas programit të inspektimit.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Shoqëria “Eurotrade Securities” sh.a, bazuar në paragrafin e parë, të nenit 31, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të sanksionohet me gjobë në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë.**

2. **Aksionari i vetëm i shoqërisë “Eurotrade Securities” sh.a. që mban dhe funksionin e administratorit të shoqërisë, bazuar në paragrafin e dytë, të nenit 31, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të sanksionohet me gjobë në masën 100,000 (njëqind mijë) lekë.**
3. **Në rast përsëritjeje të shkeljes, shoqëria do të jetë subjekt i masave të parashikuara në nenin 30, të Ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”.**
4. **Ngarkohen Departamentet përkatëse, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE